



Pranuar / Dostiguar Punijeni / Pristalo Received / Delivered	03 - 02 - 2023	3	viti god year
Organ / Shesia Organ / Jedintca Org. / Unit	SKIMSHTKA	1368 / 2023	15
Num. Prot. No. Prot.		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1302/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1302/2022 të datës 29.12.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit KA.Nr.40/22 të datës 06.12.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.1302/2022 e datës 29.12.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. *Mbetet në fuqi* Vendimi KA.nr.40/22 i datës 06.12.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 29.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8574/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.40/22 të datës 06.12.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë

04.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 20.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 29.12.2022 me numër protokoll 8574/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.40/22 të datës 06.12.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën e datës 17.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKPK; Konkursin e ri-shpallur të datës 16.09.2022 me Nr. Reference: KPK/SKPK/POZ-020 për pozitën Administrator i Lartë i Sigurisë së TI-së; Njoftim për përzgjedhje përfundimtare i datës 18.10.2022; Njoftimin për përzgjedhje përfundimtare i datës 29.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 22/2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 588/2022 e datës 20.01.2023; Formularin i regjistrimit të aplikacioneve të pranuar; Vendimin me numër DPSKPK/Nr.459/2022 i datës 03.10.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Formularin për vlerësimin individual për listën e ngushtë i datës 07.10.2022; Njoftimin për kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë i datës 07.10.2022; Listën e regjistrimit për ardhje në intervistë me gojë datë 12.10.2022; Listën e regjistrimit për ardhje në testin me shkrim datë 10.10.2022; Aplikacionin për punësim për kandidat V.P i datës 26.09.2022; Diplomën Nr.549 e datës 25.02.2013; Akt Emërimit AE.Nr.01/2021 të datës 29.12.2021; Vërtetimin e datës 14.04.2022; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 24.06.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 29.01.2021, 23.12.2019; Letër Rekomandimin; Letër rekomanduese e datës 11.03.2014; Certifikatën e muajit korrik 2021; Certifikatën e datës 11.11.2016; Certifikatën e datës 22.02.2017; Certifikatën e muajit dhjetor 2021; Certifikatën e muajit qershor 2014; Certifikatën për periudhën 08-09.11.2018; Certifikatën trajnimi për periudhën 09-10.06.2016; Mirënjohje e datës 25.11.2016; Pasqyrë e llogarisë nga Trusti; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë e datës 21.09.2022; Dokument identifikimin për kandidaten V.P; Aplikacionin për punësim të ankueses; Diplomën me Nr.558 të datës 28.03.2013; Vërtetimin e marrëdhënies së punës i datës 11.05.2022; Akt Emërimit e datës 08.10.2019, 25.03.2016 të ankueses; Kontratë mbi vepër e datës 29.04.2015; Kontratë e datës 26.11.2015; Rekomandim i datës 01.10.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 17.01.2022, 15.01.2020; Certifikatën e muajit korrik 2021; Certifikatën si trajnerë e datës 13.12.2017; Certifikatën e muajit dhjetor 2018; Certifikatë trajnimi e datës 28.04.2017; Certifikatë trajnimi qershor 2022; Certifikatë trajnimi maj 2022; Certifikatë trajnimi shtator 2020; Certifikatë trajnimi tetor 2018; Certifikatë trajnimi maj 2016; Certifikatë trajnimi shtator 2017; Certifikatë trajnimi qershor 2016; Certifikatë trajnimi shtator 2018; Certifikatë nga The Cmbridge School e datës 17.11.2010, 21.01.2009; Diplomë e datës 01.09.2003; Mirënjohje për ankuesen janar 2021; Mirënjohje për ankuesen për vitin shkollor 2004/05; Pasqyrë e llogarisë nga Trusti; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dega Glllogoc e datës 09.08.2022; kopje e ID-së së ankueses, Çelësi i testit me shkrim; Testin me shkrim të datës 12.10.2022 për kandidaten V.P dhe ankuesen; Formularin i përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim i datës 12.10.2022; Formulari i përmbledhjes së vlerësimeve të intervistës i datës 14.10.2022; Formulari i renditjes përfundimtare të kandidatëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar së janë të pabazuara pretendimet

ankimore të ankueses, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 16.09.2022 ka ri-shpallur Konkursin me numër reference: KPK/SKPK/POZ-020 për pozitën e punës *Administrator i Lartë i Sigurisë së TI-së*, i hapur për aplikim nga data 16.09.2022 deri më datë 30.09.2022, ndërsa si kritere për këtë pozitë të punës janë vendosur: *Përgatitja profesionale Diplomë Universitare në shkencat kompjuterike, informatikë dhe të ngjashme; Përvoja e punës - tri (3) vit përvojë pune në fushën e TI-së.*

Në konkursin me numër reference: KPK/SKPK/POZ-020 kanë aplikuar tetëmbëdhjetë (18) kandidatë përfshirë ankuesen, e cila i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit të kësaj procedurë të rekrutimit, mirëpo që e njëjta bazuar në vlerësimin e Komisionit Përzgjedhës nuk ka rezultuar si kandidatë i suksesshëm, përkatësisht ankuesja është vlerësuar me gjithsej 53.4 % duke u renditura si kandidati i dytë.

Ankuesja e pakënaqur me rezultatin e vlerësimit të shpallur sipas Njoftimit të datës 18.11.2022 të Njësisë së Personelit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit më Vendim me numër KA.Nr.40/22 të datës 06.12.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të datës 18.10.2022.

Kundër Vendimit KA.Nr.40/22 të datës 06.12.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së gjatë konkursit për pozitën e punës *Administrator i Lartë i Sigurisë së TI-së* ka pasur shkelje procedurale dhe materiale, konkretisht thekson së njëri nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës është në periudhë provuese respektivisht ende nuk ka marr konfirmimin nëse do të jetë apo jo në pozitën që është përzgjedhur. Kërkon që Këshilli të anuloi vendimin e kontestuar me ankesë dhe të obligoj Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të SKPK-së për eliminimin e të metave ligjore dhe procedurën ta zhvilloj në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Referuar pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil, gjegjësisht nenin 7 më të cilin është përcaktuar se: 1. *Institucionet themelojnë një Komision Përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil në tekstin në vijim KPSHC) i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbehet nga anëtarë të cilët kanë pozita me të larta se pozita që duhet të rekrutohet por një anëtar mund të ketë pozitë të njëjtë, të jetë shumë etnik dhe përfaqësim gjinor. KPSHC zhvillon procedurat e rekrutimit për pozita të karrierës dhe jo karrierës.....".* Andaj mbi këtë bazë ligjore si dhe duke u bazuar në shqyrtimin e Vendimit nën shenjën DPSKPK/Nr.459/2022 të datës 03.10.2022 të Ushtruesit të Detyrës të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kolegji ka gjetur se Komisioni Përzgjedhës i themeluar për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "*Administrator i Lartë i Sigurisë së TI-së*" ka qenë në përbërje nga: *Udhëheqësi i Divizionit për Sisteme Elektronike (softwer) në SKPK-kryesues; 2. Udhëheqësi i Divizionit për Infrastrukturë (rrjet dhe server) në SKPK-anëtar; 3. Zyrtari Certifikues në SKPK-anëtar; 4. Administrator i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-anëtar; dhe 5. Administrator i Lartë i TI-së për bazë të dhënave në SKPK-anëtar,* dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson së përbërja e Komisionit Përzgjedhës është në pajtim ne neni 7 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil.

Ndërsa, Kolegji konstaton së pretendimi ankimor i ankesës së ka pas shkelje procedurale pasi që njeri nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës ka qenë në periudhë provuese, nuk ka mbështetje ligjore, sepse me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nuk është përcaktuar kufizimi që nëpunësit civil në periudhë provuese nuk mund të jenë pjesë e komisioneve punuese gjegjësisht rekrutuese si dhe anasjelltas që anëtarët e Komisioneve Përzgjedhëse nuk mund të përbehen nga nëpunës civil në periudhë provuese.

Në kuptim të nenit 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar në aspekt procedural dhe material procedurën e rekrutimit sipas Konkursit KPK/SKPK/POZ-020 për pozitën e punës *Administrator i Lartë i Sigurisë së TI-së*, dhe rrjedhimisht ka konstatuar së shpallja e Konkursit është në pajtim me nenet 15, 16 dhe 17 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, lista e ngushtë e kandidatëve është përgatitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 26 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, testi me shkrim dhe gojë janë organizuar dhe mbajt në pajtim me nenin 32 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe së testi me shkrim ka qenë i përpiluar në pajtim me kërkesat e përcaktuara me nenin 36 të kësaj Rregullore, gjegjësisht Pjesa e I/Pjesa e Njohurive të Përgjithshme është përberë nga tre (3) ese, Pjesa e II-dytë/Pjesa e Aftësive të Përgjithshme dhe të Personalitetit, është përberë nga dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe Pjesa e III-tretë/Pjesa e Njohurive lidhur me vendin e punës është përberë nga gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, prej tyre gjysma me përgjigje të shumëfishta dhe gjysma në formë eseje të shkurtra.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të dosjes së ankueses dhe kandidatit të suksesshëm, konstaton se ankuesja posedon Diplomën me Nr.556 të datës 28.03.2013 të lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes të cilës dëshmohet se më datë 01.02.2013 ka përfunduar studimet themelore në këtë fakultet duke marr titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike, ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Vërtetimin me numë protokoll 157 të datës 11.05.2022 të lëshuar nga Akademia e Drejtësisë, sipas të cili është vërtetuar së ankuesja është duke punuar në këtë institucion dhe atë nga data 04.05.2015 deri më datë 04.10.2015 sipas kontratës për shërbime të përgjithshme në fushën e IT-së, ndërsa nga data 03.10.2019 në pozitën Administratore e Lartë e TI për Sisteme. Kandidatja e suksesshme Vildona Podrimçaku posedon Diplomën me Nr.549 të datës 25.02.2013 të lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes të cilës dëshmohet se më datë 21.01.2013 ka përfunduar studimet themelore në këtë fakultet duke marr titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike, ndërsa në bazë të Vërtetimit të datës 14.04.2022 të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes dëshmohet se e njëjta nga data 05.05.2015 deri më datë 31.12.2019 ka punuar ë Departamentin e Komunikimit dhe Teknologjisë Informative, nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 në Sektorin për Siguri Kibernetike, ndërsa sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta nga data 06.09.2021 deri më datë 23.12.2021 ka punuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në pozitën Zyrtare e Teknologjisë Informative, ndërsa në bazë të Akt Emërimit AE.Nr.01/2021 të datës 29.12.2022 e njëjta nga data 01.01.2022 është në marrëdhënie punë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale në pozitën Zyrtar i TI-së për Përkrahje. Andaj, mbi bazën e kësaj gjendje faktike Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankuesit dhe kandidatës së përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: 1.larsinimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera*

të meritë. Mirëpo, Kolegji në bazë vlerësimit përfundimtar të Komisionit Përzgjedhës ka konstatuar së kandidatja e përzgjedhur është vlerësuar më gjithsej 76.1 pikë duke u renditur si kandidati i parë, ndërsa ankuesja ka marr gjithsej 53.4 pikë duke u renditur si kandidat i dytë, kështu që Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*”.

Nisur nga konstatimet si me sipër, Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën *Administrator i Lartë i Sigurisë së TI-së* është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafi 9 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës, dhe si rrjedhojë Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.40/22 i datës 06.12.2022 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.*

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1302/2022

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.